

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-
AR73.1

Data: 31 maj 2011

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësi Patrick Robinson, Kryegjykatës
Gjykatësi Fausto Pocar
Gjykatëse Liu Daqun
Gjykatësi Andrésia Vaz
Gjykatësi Theodor Meron

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 31 maj 2011

**PROKURORI
kundër
RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI APELIN E HARADINAJT NË LIDHJE ME KUADRIN E
RIGJYKIMIT TË PJESSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Ramush Haradinajt:

Z. Ben Emmerson QC
Z. Rodney Dixon

Z.

Avokatëve të Idriz Balajt:

Z. Gregor Guy-Smith
Zj. Colleen M. Rohan

Avokatëve të Lahi Brahimajt

Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali”) ka marrë një apelim¹ të dorëzuar nga Ramush Haradinaj (“Haradinaj” ose “I Akuzuari”) më 10 shkurt 2011 kundër “Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt” lëshuar nga Dhoma Gjyqësore II e Tribunalit (“Dhoma Gjyqësore”) më 14 janar 2011 (“Vendimi i Apeluar”).² Prokuroria dorëzoi përgjigjen më 21 shkurt 2011,³ dhe Haradinaj dorëzoi kundërpërgjigjen më 25 shkurt 2011.⁴ Më 3 mars 2011, Prokuroria dorëzoi një kundërpërgjigje shtesë.⁵

I. HISTORIA PROCEDURALE

2. Më 3 prill 2008 Dhoma Gjyqësore I e Tribunalit (“Dhoma Gjyqësore I”) e shpalli Haradinajn të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt.⁶ Në Aktgjykimin e vet të 19 korrikut 2010, Dhoma e Apelit konkludoi se Dhoma Gjyqësore I nuk mori masat e nevojshme kundër frikësimit të dëshmitarëve që karakterizoi procesin gjyqësor, dhe në veçanti nuk ndihmoi Prokurorinë në kërkesat e saj për të siguruar dëshminë e dy dëshmitarëve, Shefqet Kabashi (“Kabashi”) dhe një dëshmitar tjetër, për të cilët pretendohet se kishin prova të drejtpërdrejta për fajësinë e Haradinajt.⁷ Duke marrë parasysh rëndësinë e mundshme të këtyre dëshmitarëve për çështjen e Prokurorisë, Dhoma e Apelit konkludoi se gabimi minoi ndershmërinë e procesit, dhe rezultoi në dështimin e drejtësisë.⁸ Si pasojë, Dhoma e Apelit e shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore I për

¹ Parashtrim i Apelit në Emër të Ramush Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjyimit të Pjesshëm, 10 shkurt 2011 (“Apeli”).

² *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011.

³ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjyimit të Pjesshëm, 21 shkurt 2011 (konfidencial) *Shih edhe* Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjyimit të Pjesshëm, 22 shkurt 2011 (versioni i redaktuar publik) (“Përgjigje”).

⁴ Parashtrim i Kundërpërgjigjes në Emër të Ramush Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjyimit të Pjesshëm, 25 shkurt 2011 (“Kundërpërgjigje”).

⁵ Mocion i Prokurorisë për Leje për Paraqitjen e Kundërpërgjigjes Shtesë dhe Kundërpërgjigje Shtesë ndaj Parashtrimit të Kundërpërgjigjes të Ramush Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjyimit të Pjesshëm, 3 mars 2011 (“Kundërpërgjigje Shtesë”). Kundërpërgjigja Shtesë u përqendrua vetëm në kundërshtimin e kërkesës së Haradinajt për një seancë gojore, përmendur në Kundërpërgjigjen e tij. *Shih* Kundërpërgjigje Shtesë, para 1.

⁶ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008 (“Aktgjykim”), para 502; *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt, 16 tetor 2007 (“Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt”). Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt ishte aktakuza në fuqi gjatë gjykimit.

⁷ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010 (“Aktgjykimi i Apelit”), para 34-48.

⁸ Po aty, para 40.

dhënien e pafajësisë Haradinajt dhe urdhëroi rigjykim për: (a) pjesëmarrje të Haradinajt në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (“NPK”) për të kryer krime në shtabin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) në Jabllanicë sipas Pikave 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt; dhe për (b) përgjegjësi individuale penale të Haradinajt sipas Pikave 24 dhe 34 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt (“Urdhër për Rigjykim të Pjesshëm”).⁹

3. Më 21 korrik 2010, u caktua Dhoma Gjyqësore për rigjykimin e pjesshëm.¹⁰ Më 15 shtator 2010 Dhoma Gjyqësore urdhëroi që aktakuza në fuqi gjatë rigjykimit të pjesshëm të jetë Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt dhe konkludoi se meqë Aktakuzës nuk i ishin bërë ndryshime që përbënin akuza të reja, vetëdeklarimet e pafajësisë nga Haradinaj në lidhje me të gjitha pikat më 14 mars 2005 dhe 1 mars 2007 ishin ende në fuqi në lidhje me pikat për të cilat Dhoma e Apelit kishte urdhëruar rigjykimin e Haradinajt.¹¹

4. Më 9 nëntor 2010, në zbatim të urdhrave të Dhomës Gjyqësore,¹² Prokuroria dorëzoi një version të ri dhe të shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt për rigjykim të pjesshëm (“Aktakuzë e 9 nëntorit 2010”).¹³ Në Aktakuzën e 9 nëntorit 2010, Prokuroria rinumërtoi Pikat 24, 26, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt si Pikat 1 – 6. Të gjitha Pikat e tjera të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt u fshinë.¹⁴ Në përmbushje të urdhrit të Dhomës Gjyqësore, Haradinaj dorëzoi një mocion, ku argumentonte se Aktakuza e 9 nëntorit 2010 përmbante akuza që dilnin jashtë kuadrit të rigjykimit urdhëruar nga Dhoma e Apelit dhe jashtë argumenteve të Prokurorisë në procedurën e

⁹ Po aty, para 50, 377.

¹⁰ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Urdhër për Caktimin e Gjykatësve të një Çështjeje në Dhomën Gjyqësore, 21 korrik 2010.

¹¹ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Urdhër Lidhur me Aktakuzën në Fuqi dhe Vetëdeklarimet, 15 shtator 2010, f. 3.

¹² *Shih* Konferencë mbi Gjendjen, T. 5 (23 shtator 2010); Konferencë mbi Gjendjen, T. 45-46 (26 tetor 2010); *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT; Urdhër Lidhur me Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 3 nëntor 2010 (“Urdhër i 3 nëntorit 2010”), f. 2.

¹³ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT; Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 9 nëntor 2010 (“Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar”). Fillimisht më 28 tetor 2010 Prokuroria paraqiti një version të rishikuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt “në të cilën ndryshimet janë bërë nëpërmjet përdorimit të opsionit “tracking” /shënim” dhe paragrafët e pikat nuk janë numërtuar në mënyrë të njëpasnjëshme”; për shkak të kësaj, Dhoma Gjyqësore urdhëroi që Prokuroria të paraqesë një version të ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt “në të cilin paragrafët dhe pikat të jenë numërtuar në mënyrë të njëpasnjëshme dhe ku të jenë hequr shënimet” *Shih* Urdhër i 3 nëntorit 2010, f. 2. *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT; Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 28 tetor 2010.

¹⁴ Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, Shtojca B.

apelit.¹⁵ Konkretisht. Haradinaj argumentonte se çfarëdo prove e cila nuk kishte lidhje me Jabllanicën, duhet përjashtuar nga rigjykimi dhe se akuzat në lidhje me NPK-në, pjesëmarrja e të akuzuarit dhe paraqitja e fakteve që dilnin jashtë Jabllanicës duhen rishikuar ose hequr nga Aktakuza e 9 nëntorit 2010.¹⁶

5. Më 14 janar 2011, Dhoma Gjyqësore lëshoi Vendimin e Apeluar në të cilin trajtonte kërkesën e Haradinajt për ndryshim ose heqje nga Aktakuza e 9 nëntorit 2010 të akuzave që dalin jashtë kuadrit të rigjykimit. Me arsyetimin se Dhoma e Apelit nuk synonte të ndryshonte qëllimin e përbashkët të NPK-së në gjyq, por thjesht ravijëzonte një pjesëmarrje më të kufizuar të të Akuzuarit në NPK,¹⁷ Dhoma Gjyqësore (a) urdhëroi që paragrafi 24 i Aktakuzës së 9 nëntorit 2010 të zëvendësohej prej paragrafit 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt në mënyrë që brenda qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së të përfshihej “kontrolli i UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit” dhe të mos kufizohej vetëm në keqtrajtimin e kategorive të ndryshme të civilëve;¹⁸ dhe (b) rrëzoi kërkesën e Haradinajt për ndryshimin ose heqjen nga Aktakuza e 9 nëntorit 2010 të incidenteve që nuk kishin lidhje me Jabllanicën.¹⁹ Për më tepër Dhoma Gjyqësore konkludoi se Urdhri për Rigjykim të Pjesshëm nuk përcaktonte kufij në lidhje me paraqitjen e provave të mundshme në proces prej Prokurorisë.²⁰

6. Në zbatim të Vendimit të Apeluar, Prokuroria dorëzoi një version të rishikuar të Aktakuzës së 9 nëntorit 2010, që aktualisht është aktakuza në fuqi e çështjes (“Aktakuza në Fuqi”).²¹

7. Më 3 shkurt 2011, u miratua Kërkesa e Haradinajt për leje për Apelim të Ndërkohshëm të Vendimit të Apeluar.²² Autorizimi u dha në lidhje me: (a) urdhrin në paragrafin 42(2)(b) të Vendimit të Apeluar për zëvendësimin e paragrafit 24 të Aktakuzës së 9 nëntorit 2010 me paragrafin 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt; (b) rrëzimin

¹⁵ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT; Parashtrim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Versionin e Ri të Aktakuzës për Rigjykimin e Pjesshëm, 23 nëntor 2010, para 3-7.

¹⁶ Po aty, para 3-17, 23.

¹⁷ Vendimi i Apeluar, para 28-30.

¹⁸ Po aty, para 27, 42 (2)(b).

¹⁹ Po aty, para 42(4).

²⁰ Po aty, para 41.

²¹ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT; Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 21 janar 2011, Shtojca B.

²² *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Kërkesën në Emër të Ramush Haradinajt për Leje bazuar në paragrafin B të Rregullës 73., 3 shkurt 2011.

e kërkesës së Haradinajt për ndryshimin ose heqjen nga Aktakuza e 9 nëntorit 2010 të akuzave në lidhje me incidentet që nuk kanë të bëjnë me Jabllanicën; dhe (c) rrëzimin në paragrafët 41 dhe 42(4) të Vendimit të Apeluar, e argumentit të Haradinajt se në rigjykimin e pjesëshëm Dhoma Gjyqësore duhet të dëgjojë vetëm Kabashin dhe dëshmitarin tjetër.²³

II. STANDARDI I RISHIKIMIT

8. Dhoma e Apelit rikujton se në bazë të Rregullës 54 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), një Dhomë Gjyqësore mund të lëshojë urdhra, që mund të jenë të nevojshme për hetime ose për përgatitjen apo kryerjen e procesit gjyqësor. Për prapësimin e suksesshëm të një vendimit të tillë që është në kompetencën gjykuese të Dhomës, pala apeluese duhet të provojë se Dhoma Gjyqësore ka bërë një “gabim të dukshëm”.²⁴ Dhoma e Apelit e shfuqizon një vendim të marrë mbi bazën e kompetencës vetëgjykuese të Dhomës Gjyqësore vetëm kur konkludon se vendimi: (1) bazohet në një interpretim të pasaktë të ligjit përkatës; (2) bazohet në një konkluzion qartësisht të pasaktë të fakteve; ose (3) është i padrejtë ose jologjik në atë masë sa përbën shpërdorim të kompetencës gjykuese të Dhomës Gjyqësore.²⁵

III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

9. Haradinaj ka kërkuar tejkallim të numrit-kufi të fjalëve të Apelimit të tij, nga 9000 fjalë në 14 000 fjalë me arsyetimin se tri pikat e lejuara për apelim ngrenë probleme të ndërlikuara ligjore ende të pashqyrtuara prej Tribunalit dhe të cilat janë “aspekte të reja me rëndësi të konsiderueshme”, që rrjedhimisht përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme.²⁶ Gjithashtu ai ka kërkuar tejkallim të numri-kufi prej 3000 fjalësh, në 3500 fjalë në Kundërpërgjigjen e tij për shqyrtimin e të gjitha argumenteve të ngritura prej Prokurorisë në Përgjigjen e vet.²⁷

²³ Po aty, para 20.

²⁴ *Shih Prokurori k. Ante Gotovinës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-06-90-AR73.5 Vendim mbi Apelin e Mbrojtjes së Gotovinës Kundër Vendimit të 12 marsit 2010 mbi Kërkesat për Urdhër të Përhershëm Kufizues Drejtuar Republikës së Kroacisë 14 shkurt 2011 (“Vendimi Gotovina”), para. 14; *Prokurori k Radovan Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-05-95-5/18-AR73.8. Vendim mbi Apelin e Urdhrit për Grafikun e Procesit Gjyqësor, 18 korrik 2010 (“Vendimi Karaxhiq”), para 5.

²⁵ *Vendimi Gotovina*, para. 14; *Vendimi Karaxhiq*, para 5.

²⁶ Apeli, para 13. *Shih Udhëzim Praktik mbi Gjatësinë e Parashtrimeve dhe Mocioneve*, IT/184 Rev.2, 16 shtator 2005 (“Udhëzim Praktik mbi Gjatësinë e Parashtrimeve dhe Mocioneve”), para I(C)(2)(1).

²⁷ Kundërpërgjigje, sh. 2. *Shih Udhëzim Praktik mbi Gjatësinë e Parashtrimeve dhe Mocioneve*, para I(C)(2)(3).

10. Dhoma e Apelit gjykon se pikat e ngritura në këtë apel janë aspekte të rëndësishme të pashqyrtuara më parë nga Dhoma e Apelit dhe kyçe në përcaktimin e kuadrit të rigjyqimit të pjesshëm që do të fillojë në kohën e përshtatshme. Megjithëse rëndësia e pikave të ngritura në vetvete nuk përbën pengesë që apeluesi të paraqesë argumente të bazuara brenda kufirit të lejuar të fjalëve,²⁸ Dhoma e Apelit konkludon se rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje përligjin tejkalinimin e numrit-kufi të fjalëve dhe rrjedhimisht miraton tejkalinimin e kufirit të fjalëve.²⁹

IV. DISKUTIM

11. Në Apelim, Haradinaj argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi: (1) kur rrëzoi parashtrimin e Haradinajt se provat në rigjykim duhet të përfshijnë vetëm dhënien e dëshmisë prej Kabashit dhe dëshmitarit tjetër, dhe se Prokuroria nuk mund të shfrytëzojë prova të reja në gjyq;³⁰ (2) kur konkludoi se Aktakuza në Fuqi duhet të përfshijë të njëjtën akuzë për NPK-në si gjatë gjyqimit të parë të Haradinajt;³¹ dhe (3) kur rrëzoi kërkesën e Haradinajt për fshirjen e të gjitha akuzave nga Aktakuza në Fuqi në lidhje me incidentet që nuk kanë të bëjnë me gjashtë pika që janë objekt i rigjyqimit.³²

12. Rrjedhimisht Haradinaj kërkon që Dhoma e Apelit të nxjerrë një urdhër: (1) që kufizon kuadrin e rigjyqimit të pjesshëm vetëm në thirrjen e dëshmitarit Kabashi dhe të dëshmitarit tjetër;³³ (2) që kufizon pretendimin për NPK-në në lidhje me rigjykimin në një NPK të përqendruar mbi akuzat e përfshira në gjashtë pikat që janë objekt i rigjyqimit;³⁴ dhe (3) që fshin nga Aktakuza në Fuqi të gjitha akuzat për sjellje kriminale që nuk kanë lidhje me

²⁸ *Prokurori k. Vujadin Popoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-88-A, Vendim mbi Mocionin e Radevoje Miletiqit për Leje për Tejkalinim Shtesë të Numrit-Kufi të Fjalëve. 18 janar 2011, f.2; *Në Çështjen Kundër Florence Hartmann-it*, Lënda Nr. IT-02-54-R775.A, Vendim mbi Mocionin për Mosmarrje në Konsideratë dhe Kërkesa për Tejkalinimin e Numrit-Kufi të Fjalëve, 6 nëntor 2009, para 24, *citohet Prokurori kundër Naser Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-A, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Tejkalinimin e Numrit-Kufi të Fjalëve për Parashtrimin Apelues të Mbrojtjes, 6 tetor 2008 ku në f. 3 shkruhet se “[...] ndonëse ky apel ngre probleme të rëndësishme të ligjit dhe të faktit, Mbrojtja duhet të provojë rrethana të jashtëzakonshme të cilat e dallojnë këtë çështje dhe që përligjin tejkalinimin e numrit-kufi të përcaktuar të fjalëve”; *Prokurori k. Nikolla Shainoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-A, Vendim Mocionin e Përbashkët të Nikolla Shainoviqit dhe Dragolub Ojdaniqit për Tejkalinimin e Numrit-Kufi të Fjalëve, 11 shtator 2009, f 3-4.

²⁹ Dhoma e Apelit ka gjithashtu parasysh se kërkesa e mëtejshme e Haradinajt për seancë u hodh poshtë. *Shih Kundërpërgjigje*, para 6-7; Vendim mbi Kërkesën për Argument Gojor, 16 mars 2011, f. 2.

³⁰ Apeli, para 19-24, 41-55.

³¹ Po aty, para 25-26, 56-65.

³² Po aty, para 27, 66-76.

³³ Po aty, para 24, 28(a).

³⁴ Po aty, para 28(b).

gjashtë pikat që janë objekt i rigjykimit dhe për të cilat Haradinaj është shpallur i pafajshëm.³⁵

A. Pika e Parë e Apelit: A duhet të dëgjojë Dhoma Gjyqësore vetëm Kabashin dhe dëshmitarin tjetër të cilët Prokuroria nuk u lejua t'i thërriste në gjyq

1. Parashtrime të Palëve

13. Haradinaj argumenton se rihapja e një çështjeje pas një vendimi të formës së prerë është mjet ligjor i pazakontë.³⁶ Ai parashtron se “meqenëse rigjykimi është devijim nga parimi i përfundimësisë, ai duhet të ofrojë një mjet ligjor të përshtatur për ndreqjen e një gabimi qartësisht të identifikuar në procesin gjyqësor dhe asgjë më shumë.”³⁷ Haradinaj parashtron se gabimi i identifikuar në çështjen aktuale ishte se Dhoma Gjyqësore I nuk i ofroi Prokurorisë mundësinë që i takonte për thirrjen e dy dëshmitarëve, Kabashit dhe dëshmitarit tjetër, dhe rrjedhimisht mjeti i përshtatshëm ligjor për ndreqjen e këtij gabimi është një urdhër për rigjykim të pjesshëm që mundëson thirrjen e dy dëshmitarëve të lartpërmendur.³⁸ Haradinaj argumenton se Dhoma Gjyqësore duhet t'i peshojë dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve duke i krahasuar me provat e paraqitura në gjykimin e parë, për të përcaktuar nëse ato do të kishin ndikuar në vendimin e Dhomës Gjyqësore I.³⁹ Ai parashtron se lejimi që Prokuroria të paraqesë dëshmi të tjera veç dëshmive të dy dëshmitarëve, do të ishte privilegj i papërligjur për Prokurorinë, shkelje e parimeve *non bis in idem*, *res judicata* dhe i përfundimësisë, dhe do të ishte e ndaluar prej përjashtimit garantues paraprak ose doktrinës së shpërdorimit të procesit në procedura penale.⁴⁰ Haradinaj argumenton se Vendimi *Muvunyi* është i ndryshëm nga kjo çështje duke qenë se trajton kuadrin e dëshmive që do të dëgjohen në rigjykim pas një apeli të të akuzuarit kundër verdiktit të fajësisë.⁴¹ Ai argumenton se “në atë çështje nuk ishte fjala për parimet e vlefshme gjatë apelimit.”⁴² Konkretisht ai parashtron

³⁵ Po aty, para 28(c)

³⁶ Po aty, para 2, sh. 1

³⁷ Po aty, para 3.

³⁸ Po aty, para 4-11, 41-45.

³⁹ Po aty, para 4, 23-24.

⁴⁰ Po aty, para 10, 22, 29, 32-33, 35-39, 54: *shih* edhe Kundërpërgjigje, para 4.

⁴¹ Apeli, para 40; Kundërpërgjigje, para 13. *që i referohet Prokurori k. Tharcisse Muvunyi*, Lënda Nr. ICTR 2000-55/A-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë Lidhur me Kuadrin e Provave që do të paraqiten në Rigjykim, 24 mars 2009 (“Vendimi *Muvunyi*”).

⁴² Apeli, para 40.

se “nuk ishte fjala për mbrojtje të të akuzuarit ndaj rrezikut të dyfishtë, dhe rigjykimi nuk ishte rigjykim i pjesshëm i urdhëruar si mjet ligjor për ndreqjen e një gabimi të kufizuar dhe të marrë veçazi.”⁴³

14. Gjithashtu Haradinaj argumenton se nuk mund lejohet që në rigjykim Prokuroria të riargumentojë pika të cilat mund të ishin ngritur në apelim në lidhje me të cilin u urdhërua rigjykimi i pjesshëm.⁴⁴ Haradinaj argumenton se “do të ishte kundër parimeve themelore të së drejtës dhe procedurës penale që Prokuroria [...] të lejohet të argumentojë çështjen e saj [...] nëpërmjet paraqitjes së dëshmitarëve të rinj dhe të kompensojë mangësitë [...] e gjykimit të parë nëpërmjet provave shtesë”.⁴⁵ Konkretisht, Haradinaj argumenton se nuk duhet lejuar që Prokuroria të thërrisë gjashtë dëshmitarë të mundshëm të identifikuar nga Prokuroria në Dosjen e vet Paragjyqësore të 6 dhjetorit 2010.⁴⁶ Haradinaj argumenton se deklaratat e gjashtë dëshmitarëve bëjnë fjalë për incidente për të cilat pretendohet se ndodhën jashtë Jabllanicës dhe nuk kanë lidhje me gjashtë pikat që janë objekt i rigjyimit.⁴⁷ Gjithashtu ai pretendon se pranimi i dëshmive të gjashtë dëshmitarëve të rinj do të ishte paragjykes dhe shpërdorim i procesit duke qenë se Prokuroria ia paraqiti atij në dhjetor 2010, më shumë se dy vjet pas Aktgjyimit të nxjerrë nga Dhoma Gjyqësore, ndërkohë që hetimet e Prokurorisë nisën që para vitit 2004.⁴⁸ Ai argumenton se rrethanat e çështjes së tij janë krejt të ndryshme nga çështja *Muvunyi*, ku dëshmitarët e rinj të propozuar i ishin bërë të ditur të akuzuarit që në kohën e gjyimit të shkallës së parë.⁴⁹ Haradinaj parashtroi se nuk duhet lejuar që Prokuroria të paraqesë një dëshmitar ekspert për të cilin megjithëse Haradinaj u informua në gjyq, ai nuk u thirr për të dëshmuar në gjykimin e shkallës së parë dhe që prej asaj kohe Prokuroria ka marrë deklaratat të reja prej tij.⁵⁰

15. Më tej Haradinaj argumenton se nuk duhet lejuar që Prokuroria të paraqesë prova të cilat u konsideruan të papranueshme në gjykimin e shkallës së parë.⁵¹ Ai pretendon se meqenëse këto konkluzione nuk u apeluar nga Prokuroria gjatë gjyimit ose apelit, ato duhet të marrin formë të prerë, duke e ndaluar Prokurorinë në riparaqitjen e këtyre provave kundër

⁴³ Po aty; Kundërpërgjigje, para 13.

⁴⁴ Apeli, para 11, 22, 46, 48, 53.

⁴⁵ Po aty, para 49.

⁴⁶ Po aty, para 20, 49.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Po aty, para 22, 49-50, 67.

⁴⁹ Po aty, para 40.

⁵⁰ Po aty, para 20.

⁵¹ Po aty, para 20, 22, 54; Kundërpërgjigje, para 16.

tij.⁵² Së fundi, ai argumenton se lejimi i Prokurorisë në paraqitjen e provave të reja në rigjykim, efektivisht do t'i mundësonte asaj që të shmangte Rregullën 115 të Rregullores, të cilën mund ta kishte shfrytëzuar gjatë fazës së apelit për pranimin e “provave të reja”.⁵³

16. Prokuroria përgjigjet se rigjykimi është mjet ligjor i gjerë, se kufizimi mbi paraqitjen e provave që do të paraqiten gjatë rigjykit duhet të jetë formuluar qartë në urdhrin për rigjykimin, dhe në Urdhrin për Rigjykim të Pjesshëm nuk ekzistojnë kufizime të tilla.⁵⁴ Sipas Prokurorisë, “rigjykimi është gjykim i ri i cili procedon mbi pandehmën se nuk ka patur gjykim të mëparshëm.”⁵⁵ Ajo argumenton se “qëllimi i rigjykit të pjesshëm është vërtetimi i përgjegjësisë së të akuzuarit për pikat e rigjykit dhe në vetvete përmban mundësinë e dëgjimit të dëshmive të reja.”⁵⁶ Prokuroria argumenton se e drejta penale shtetërore parashikon raste të rigjytimeve ku përfshihet mundësia e dëgjimit të dëshmive të cilat nuk u dëgjuan gjatë procesit të parë, nëpërmjet citimit të shembujve nga praktika shtetërore.⁵⁷ Për më tepër ajo parashtrohet se Dhoma e Apelit e ka përvijuar rigjykimin ndaj gabimit të prapësueshëm i cili ishte shkak i rigjykit, duke e kufizuar procesin në pikat mbi Jabllanicën.⁵⁸ Prokuroria argumenton se pranueshmëria e provave është çështje për të cilën vendos Dhoma Gjyqësore, dhe do të ishte e parakohshme që Dhoma e Apelit të ndërhynte në aspekte të tilla para se ato të jenë debatuar juridikisht para Dhomës Gjyqësore.⁵⁹ Prokuroria mendon se “kufizimi i përgjithshëm” ndaj provave shtesë do ta privonte Dhomën Gjyqësore prej “provave kyçe”, duke e zmadhuar në këtë mënyrë gabimin e identifikuar nga Dhoma e Apelit kur urdhëroi rigjykimin për t'i ofruar Prokurorisë mundësinë e paraqitjes së “provave të tjera kyçe”.⁶⁰

17. Gjithashtu Prokuroria parashtrohet se në mungesë të një verdikti fajësie apo pafajësie të formës së prerë për pikat e rigjykit, provat të cilat përmbushin kushtet e pranueshmërisë në lidhje me këto pika, mund të pranohen dhe të përdoren nga Dhoma Gjyqësore e ngarkuar për rigjykimin, pavarësisht se ato u konsideruan të papranueshme në gjykimin e parë.⁶¹ Më tej

⁵² Apeli, para 22, 46, 53-54.

⁵³ Po aty, para. 53.

⁵⁴ Përgjigje, para 2, 6-7, 14, 20.

⁵⁵ Po aty, para. 5.

⁵⁶ Po aty, para. 15.

⁵⁷ Po aty, para. 10, sh. 29.

⁵⁸ Po aty, para. 12.

⁵⁹ Po aty, para. 3, 7, 15, 17-20, 23-24.

⁶⁰ Po aty, para. 19.

⁶¹ Po aty, para. 27-29.

Prokuroria përgjigjet se mjeti ligjor i kërkuar në apelin e Prokurorisë kundër Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore nuk ishte thjesht dhënia e dëshmisë prej dy dëshmitarëve; theksi i mëshuar këtyre dy dëshmitarëve në apelin e Prokurorisë u përdor për të provuar se si gabimet e Dhomës Gjyqësore I zhvlerësuan Aktgjykimin ose rezultuan në dështim të drejtësisë.⁶² Argumentohet se mjeti i përshtatshëm ligjor ishte shfuqizimi i verdikteve të pafajësisë së të Akuzuarve në lidhje me pikat e Jabllanicës dhe një rigjykim në lidhje me këto pika.⁶³ Për më tepër, Prokuroria argumenton se Haradinaj nuk ofron asnjë arsye të vlefshme që do të ishte ndryshe nga precedenti i krijuar nga Vendimi *Muvunyi*.⁶⁴ Sipas mendimit të saj, “thjesht fakti” që Vendimi *Muvunyi* kishte të bënte me apelin e një të akuzuari kundër vendimit të fajësisë nuk është i mjaftueshëm për t’a dalluar atë nga çështja aktuale.⁶⁵

18. Në lidhje me parimin *non bis in idem*, Prokuroria argumenton se “përdorimi i provave në lidhje me akuzat për të cilat Haradinaj u shpall i pafajshëm nuk e shkel parimin e rrezikut të dyfishtë sepse Prokuroria nuk synon ta fajësojë Haradinajn në lidhje me këto akuza”; ajo synon t’i përdorë këto prova për të vërtetuar përgjegjësinë e tij në lidhje me pikat për Jabllanicën.⁶⁶ Prokuroria deklaron se paanësia në lidhje me të akuzuarin është “vetëm një ndër” faktorët e marrë parasysh prej gjykatës kur vendoset nëse provat e paraqitura në një gjykim të mëparshëm që kanë rezultuar në verdikt pafajësie, mund të pranohen në një proces të mëpasshëm.⁶⁷

19. Haradinaj kundërpërgjigjet se tri pikat e lejuara për tu apeluar nuk kanë të bëjnë me pranueshmërinë e provave në rigjykim bazuar në rregullat mbi pranimin e provave, por lidhen me “karakterin dhe kuadrin” e rigjykimit të pjesshëm.⁶⁸ Ai kundërshton parashtrimin e Prokurorisë se rigjykimi është “mjet ligjor i gjerë”, duke argumentuar se kjo pikëpamje nuk ka bazë në jurisprudencën ndërkombëtare ose shtetërore dhe nuk mund të interpretohet prej Rregullës 117 (C) të Rregullores.⁶⁹ Veçanërisht, ai argumenton se pas dhënies së pafajësisë, kuadri i rigjykimit, duhet përcaktuar qartë dhe duhet interpretuar ngushtë për arsye se “ekziston një ndryshim themelor midis një personi të shpallur fajtor i cili nëpërmjet apelimit të tij kundër fajësisë, siguron rigjykim [...] dhe një personi të

⁶² Po aty, para. 14, 16.

⁶³ Po aty, para. 16.

⁶⁴ Po aty, para. 8.

⁶⁵ Po aty, para. 11.

⁶⁶ Po aty, para. 27.

⁶⁷ Po aty, para. 29.

⁶⁸ Kundërpërgjigje, para 2.

⁶⁹ Po aty, para. 3, 11.

shpallur të pafajshëm i cili për shkak të apelit të Prokurorisë, rigjykohet për të njëjtat akuza për të cilat nuk u shpall fajtor.”⁷⁰ Ai argumenton se jurisprudenca dhe legjislacioni cituar prej Prokurorisë, kanë të bëjnë me rigjykime pas shpalljes së fajësisë dhe “rrjedhimisht nuk kanë asnjë ndikim të drejtpërdrejtë mbi faktet e kësaj çështjeje.”⁷¹ Haradinaj parashtron se fakti që Prokurorisë do ti jepej një mundësi e dytë për ta fajësuar “duke qenë në dijeni të dobësisë së argumentit të vet dhe të mbrojtjes” në një rigjykim pas dhënies së pafajësisë, do të thotë që Dhoma e Apelit duhet të kufizojë kuadrin e rigjykimit për ndreqjen e gabimit të bërë nga Dhoma Gjyqësore I.⁷²

20. Gjithashtu Haradinaj argumenton se Dhoma e Apelit në fakt e kufizoi kuadrin e rigjykimit duke qenë se gjashtë pikat për rigjykim lidhen drejtpërsëdrejti me dëshmitë që mund të jepeshin prej dy dëshmitarëve.⁷³ Sipas parashtrimit të tij, kufizimi i kuadrit të rigjykimit në dëgjimin e dëshmimeve të dy dëshmitarëve është “i dukshëm” në Aktgjykimin e Apelit, ku theksi iu mëshua pazotësisë së Dhomës Gjyqësore I për sigurimin e dëshmisë së këtyre dy dëshmitarëve “kyç”.⁷⁴

2. Analizë

21. Në paragrafin (C) të Rregullës 117 të Rregullores përcaktohet se “në rrethana të përshtatshme, Dhoma e Apelit mund të urdhërojë që i akuzuari të rigjykohet sipas ligjit”. As në Statutin e Tribunalit (“Statuti”), as në Rregullore nuk trajtohet kuadri i provave që paraqiten në rigjykim.

22. Dhoma e Apelit kishte rast të shqyrtonte çështjen e paraqitjes së provave të reja në rigjykimin e pjesshëm të Tharcisse Muvunyi-t.⁷⁵ Ajo konkludoi se bazuar në paragrafin (C) të Rregullës 118 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (ekuivalenti i Rregullës 117 (C) të Rregullores), prova jo të paraqitura në procesin e parë, mund të pranohen në rigjykim.⁷⁶ Gjithashtu u konkludua se

⁷⁰ Po aty, para. 12. *Shih* edhe po aty, para. 8.

⁷¹ Po aty, para. 3. *Shih* edhe po aty, para. 17.

⁷² Po aty, para. 12.

⁷³ Po aty, para. 8-9.

⁷⁴ Po aty, para. 9-10.

⁷⁵ Vendimi *Muvunyi*; *shih* edhe *Tharcisse Muvunyi k. Prokurorit*, Lënda Nr. ICTR-00-55/A-A, Aktgjykim, 29 gusht 2008, para 148, 171.

⁷⁶ Vendimi *Muvunyi*, para 13.

çfarëdo kufizimi ndaj kuadrit të rigjyimit duhet bërë “shprehimisht i qartë” nga Dhoma e Apelit.⁷⁷

23. Dhoma e Apelit thekson se Vendimi *Muvunyi* kishte të bënte me një rigjykim pas dhënies së fajësisë, kurse rigjykimi i Haradinajt vjen pas dhënies së pafajësisë së tij. Mirëpo, as në tekstin e Rregullës 117 (C) të Rregullores, as në Vendimin *Muvunyi* nuk sugjerohet se ky ndryshim automatikisht ndikon në parametrat e një rigjykimi. Përkundrazi, në Vendimin *Muvunyi* u theksua se në çfarëdo rigjykimi, Dhoma e re Gjyqësore mvishet me të drejtën e përcaktimit të kuadrit të provave të pranuar, varësisht nga Rregullorja dhe jurisprudenca e Tribunalit në lidhje me pranimin e provave si dhe çfarëdo kufizimesh shtesë të përcaktuara nga Dhoma e Apelit.⁷⁸

24. Haradinaj gabon në argumentin e tij se konkluzioni i Vendimit të Apeluar se Prokuroria mund të kërkojë dëshmi të tjera veç dy dëshmitarëve të cilët ishin në qendër të vëmendjes së Aktgjyimit të Apelit, minon parimin ligjor për “garantimin e qartësisë dhe përfundimësisë në procedura penale”.⁷⁹ Në Vendimin *Muvunyi* u konkludua se “rigjykimi [...] në vetvete përmban mundësinë e dëgjimit të dëshmive të cilat nuk u paraqitën në procesin e parë” dhe u theksua se kuadri i rigjyimit “përcaktohet nga Dhoma e Apelit në një rast konkret.”⁸⁰ Rrjedhimisht Dhoma e Apelit mund të përcaktojë parametrat e përshtatshëm të një rigjykimi, duke mbajtur parasysh kontekstin konkret të çdo çështjeje, ndër të tjera faktin nëse rigjykimi pason një verdikt fajësie apo pafajësie, si dhe parimet përkatëse të së drejtës. Në Vendimin e Apeluar, Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se Urdhri për Rigjykim të Pjesshëm nuk përcaktonte kufizime mbi provat që do të paraqiten për vërtetimin e akuzave kundër Haradinajt,⁸¹ veç kufizimeve në fuqi për çdo proces gjyqësor në Tribunal.⁸²

25. Dhoma e Apelit nuk është bindur nga argumenti i Haradinajt se vendimi i procesit të parë gjyqësor në lidhje me pranimin e provave duhet të jetë detyrues mbi Dhomën

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ *Shih* po aty. Nuk u bë asnjë dallim midis një rigjykimi pas dhënies së pafajësisë dhe një rigjykimi pas dhënies së fajësisë.

⁷⁹ Apeli, para 2. *Shih* edhe po aty, para 22, 24, 28-29, 51, 54. Ndër këto parime ligjore përfshihen *res judicata*, *non bis in idem*, dhe ndalimi kushtëzues.

⁸⁰ Vendimi *Muvunyi*, para 12-13.

⁸¹ *Shih* Vendimi i Apeluar, para 41; Aktgjykimi i Apelit, para 50, 377.

⁸² Dhoma e Apelit thekson se si rregull, për shkak të kuadrit të kufizuar të rigjyimit, Haradinaj nuk rrezikon të fajësohet në lidhje me akuzat për të cilat ai është shpallur përfundimisht i pafajshëm.

Gjyqësore që procedon rigjykimin.⁸³ Kontekstet e ndryshme të dy proceseve gjyqësore sugjerojnë se vendimet e provave në një rast mund të mos jenë të përshtatshme për procesin tjetër. Në këto rrethana, mundësia e mospërputhjes në lidhje me një aspekt provash midis gjykimit dhe rigjykimit nuk është e padrejtë dhe nuk vë në rrezik besimin publik në procedimin e drejtësisë prej Tribunalit. Në lidhje me argumentin e Haradinajt për Rregullën 115 të Rregullores, Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se në fazën e apelit dhe në rigjykim zbatohen standarde të ndryshme të pranueshmërisë së provave; rrjedhimisht çfarëdo moszbatimi i standardit për pranimin e provave sipas Rregullës 115 të Rregullores gjatë apelit nuk përjashton pranimin e provave në një proces gjyqësor pasues.

26. Dhoma e Apelit nënvizon se fakti nëse rigjykimi kryhet pas një verdikti fajësie ose pafajësie nuk do të thotë automatikisht se është i parëndësishëm. Mirëpo konteksti i çdo rigjykimi është i veçantë në vetvete dhe ndikimi i verdiktit të mëparshëm të fajësisë ose pafajësisë mund të shqyrtohet vetëm duke marrë parasysh kontekstin konkret. Çfarëdo mundësie për paragjykim të tepruar ndaj një të akuzuari në rigjykim pasi ai është shpallur i pafajshëm, trajtohet paralelisht nëpërmjet përvijimit të kujdesshëm të parametrave të rigjykimit prej Dhomës së Apelit dhe detyrës në vijimësi të Dhomës Gjyqësore për jetësimin e parimeve të një gjykimi të drejtë.⁸⁴ Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit e udhëzon Dhomën Gjyqësore që gjatë përcaktimit të pranueshmërisë së provave në rigjykim, të jetë veçanërisht e kujdesshme kundrejt çfarëdo paragjykimi të mundshëm shkaktuar nga pranimi i provave të reja ndaj së drejtës së të Akuzuarit për gjykim të drejtë. Në rast se Prokuroria synon të paraqesë prova që janë përjashtuar në procesin e mëparshëm, Dhoma Gjyqësore qartësisht duhet të peshojë nëse rihapja e të njëjtit argument në rigjykim do të shkaktonte paragjykim të tepruar. Në një rast të tillë provat nuk duhen pranuar.

27. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e rrëzon këtë pikë të Apelit

B. Pika e Dytë e Apelit: A duhet të përfshijë Aktakuza në Fuqi të njëjtën akuzë për NPK-në si në gjykimin e parë

⁸³ *Shih* Apeli, para 20, 22, 54.

⁸⁴ *Shih* Vendimi i Apeluar, para 18, ku shkruhet “të gjitha parimet për një gjykim të drejtë në lidhje me procesin gjyqësor zbatohen edhe në rastin e rigjykimeve.”

1. Parashtrimet e Palëve

28. Haradinaj parashtron se Aktakuza në Fuqi duhet ta kufizojë NPK-në si një qëllim të përbashkët për kryerjen e krimeve në Jabllanicë, të pretenduara në gjashtë pikat që janë objekt i rigjyimit. Haradinaj argumenton se meqenëse Dhoma Gjyqësore I e shpalli të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat e ripërfshira në NPK-në e shtjelluar në paragrafin 24 të Aktakuzës në Fuqi dhe konkluzionet përkatëse nuk u apeluar, ato kanë fituar cilësinë *res judicata* dhe nuk mund të ridebatohen juridikisht.⁸⁵

29. Megjithëse Prokuroria pajtohet me Haradinajn se Aktakuza në Fuqi duhet ta kufizojë NPK-në në një qëllim të përbashkët për kryerjen e krimeve të pretenduara në gjashtë pikat të cilat janë objekt i rigjyimit, ajo përgjigjet se ndryshimi i qëllimit të përbashkët në paragrafin 24 të Aktakuzës në Fuqi është i panevojshëm, duke qenë se përfshin qëllimin e përbashkët për kryerjen e krimeve në Jabllanicë.⁸⁶ Prokuroria argumenton se për shkak se Dhoma Gjyqësore mund ta shpallë të Akuzuarin fajtor nëpërmjet qëllimit të përbashkët, nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë qëllim të përbashkët jashtë krimeve të kryera në Jabllanicë.⁸⁷

30. Haradinaj kundërpërgjigjet se Prokuroria ka detyrim të vërtetojë të tëra akuzat mbi të cilat mbështetet Aktakuza në Fuqi, për shkak se Prokurorisë nuk mund t'i jepet "privilegji" i një NPK-je shumë të gjerë në Aktakuzën në Fuqi, që i mundëson të paraqesë prova jashtë akuzave për krimet e kryera në Jabllanicë, në një kohë që nuk i kërkohet të vërtetojë akuzën për NPK të gjerë.⁸⁸

2. Analizë

31. Në Vendimin e Apeluar, Dhoma Gjyqësore përcaktoi se në Urdhrin për Rigjykim të Pjesëshëm, Dhoma e Apelit nuk synoi të ndryshonte qëllimin e përbashkët në asnjë lloj mënyre.⁸⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dhoma e Apelit kishte përfytyruar jo një NPK

⁸⁵ Apeli, para 26, 57, 64.

⁸⁶ Përgjigje, para. 4.

⁸⁷ Po aty, para 31.

⁸⁸ Kundërpërgjigje, para 5, 19-20.

⁸⁹ Vendimi i Apeluar, para. 28.

më të kufizuar, por një “pjesëmarrje më të kufizuar të të Akuzuarit” në NPK, e cila mbetet njëlloj si në Aktakuzën fillestare.⁹⁰

32. Dhoma e Apelit me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Robinson, konstaton se Dhoma Gjyqësore nuk bëri asnjë gabim të dukshëm në konkluzionin e vet.⁹¹ Dhoma e Apelit nuk synoi të ndryshonte kuadrin e NPK-së kur konkludoi se Haradinaj do të rigjykohej vetëm për “pjesëmarrje në një NPK për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë”.⁹² Ajo vetëm shprehu qartë cilat krime do të rigjykoheshin. Pakësimi i akuzave për rigjykim nuk ndryshon kuadrin më të gjerë të akuzës për NPK. Meqenëse Dhoma Gjyqësore nuk mund të nxjerrë përfundime në lidhje me përgjegjësinë e Haradinajt për akuza të tjera veç atyre që përmbajnë gjashtë pikat, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Robinson, konkludon se faktori i një NPK-je më të gjerë brenda kontekstit të rigjykimit nuk e ballafaqon atë me rrezik të dyfishtë të mundshëm ose ndryshe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e tij themelore.

33. Dhoma e Apelit gjithashtu nënvizon argumentin e Haradinajt në lidhje me kuadrin e fakteve që Prokuroria duhet të provojë për vërtetimin e NPK-së.⁹³ Në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit vë në dukje se vlerësimi i provave të paraqitura nga palët në rigjykim i takon Dhomës Gjyqësore.

34. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit e hedh poshtë këtë pikë të apelit.

C. Pika e Tretë e Apelit: A duhen fshirë nga Aktakuza në Fuqi akuzat që nuk kanë lidhje me gjashtë pikat të cilat janë objekt i rigjykimit

1. Parashtrime të Palëve

35. Haradinaj kërkon që disa paragrafë në lidhje me pretendimin për pjesëmarrjen e tij në NPK dhe që përfshihen në pjesën “Paraqitje e Fakteve” të Aktakuzës në Fuqi, të fshihen, duke qenë se ato përfshijnë akuza për veprime të paligjshme për të cilat Haradinaj është shpallur i pafajshëm, pa u apeluar prej Prokurorisë dhe të cilat nuk kanë lidhje me

⁹⁰ Po aty., para 30 (theksi në origjinal)

⁹¹ Po aty.

⁹² Aktgjykimi i Apelit, para 50, 377.

⁹³ Kundërpërgjigje, para 5, 19.

gjashtë pikat e rigjykimit.⁹⁴ Ai argumenton se përfshirja e akuzave të tilla në Aktakuzën në Fuqi shkel parimin *res judicata* dhe përbën shpërdorim të procesit.⁹⁵ Megjithëse Haradinaj pranon se Prokuroria nuk synon ta fajësojë për krimet për të cilat ai është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ai argumenton se paraqitja e provave në lidhje me krime të tilla është shkelje e parimit të përfundimësisë.⁹⁶

36. Konkretisht, Haradinaj argumenton se nënparagrafët (a) – (f) të paragrafit 28 të Aktakuzës në Fuqi nuk e përmendin Jabllanicën, fakt që do t'i mundësonte Prokurorisë të paraqiste prova në lidhje me pretendimin mbi veprime të paligjshme të Haradinajt, për të cilat është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë.⁹⁷ Gjithashtu ai kundërshton përfshirjen e nënparagrafëve (j) – (m) të paragrafit 28 të Aktakuzës në Fuqi, ku përfshihen pretendime që përmendin ose i referohen Jabllanicës si vend ku u kryen veprime të paligjshme në kuadër të një qëllimi më të gjerë të përbashkët.⁹⁸ Gjithashtu Haradinaj parashtron se “Paraqitja e Fakteve” në Aktakuzën në Fuqi përmban pretendime që nuk kufizohen në gjashtë pikat e Jabllanicës, por në lidhje krime për të cilat ai është shpallur përfundimisht i pafajshëm.⁹⁹ Sipas mendimit të tij, duhen mbajtur vetëm paragrafët 39-41 të Aktakuzës në Fuqi të cilët përmbajnë akuzat për krime në Jabllanicë.¹⁰⁰

37. Më tej Haradinaj parashtron se pretendimi i nënparagrafit (c) të paragrafit 28 të Aktakuzës në Fuqi se ai përjashtoi të tëra forcat rivale të UÇK-së nga Zona Operative e Dukagjinit, për shembull Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, për t'i mundësuar ushtarëve të tij që të kontrollonin zonën dhe përndiqnin civilë, del jashtë akuzave për krime të kryera në Jabllanicë dhe nuk ka kurrfarë rëndësie në lidhje me këto akuza.¹⁰¹ Ai argumenton se megjithëse ky pretendim kishte rëndësi për akuzën e NPK-së së gjerë në gjykimin e parë, e cila kishte të bënte me konsolidimin e kontrollit ushtarak mbi zonën e Dukagjinit, ai u shpall i pafajshëm për akuzën e pjesëmarrjes në NPK, dhe lejimi i paraqitjes së provave në rigjykim do të rihapte çështje faktike tashmë të përcaktuara përfundimisht në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore dhe të paapeluara më

⁹⁴ Apeli, para 27, 66.

⁹⁵ Po aty, para 67.

⁹⁶ Kundërpërgjigje, para 17.

⁹⁷ Apeli, para 68.

⁹⁸ Po aty.

⁹⁹ Po aty, para 73.

¹⁰⁰ Po aty, para 74.

¹⁰¹ Po aty, para 69-71.

pas.¹⁰² Gjithashtu Haradinaj argumenton se Prokuroria synon të paraqesë dëshmi nga anëtarë të familjes Stojanoviq lidhur me pretendimin për implikim të Haradinajt në rrahje, në lidhje me të cilin ai u shpall i pafajshëm. Ai argumenton se jo vetëm që dëshmi të tilla janë të ndaluara prej parimit të përfundimësisë, por gjithashtu ato nuk kanë lidhje me gjashtë pikat e Jabllanicës, si edhe fakti se pretendohet që kanë ndodhur në një datë para fillimit të konfliktit të armatosur, siç u provua në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore I.¹⁰³

38. Prokuroria përgjigjet se ndonëse qëllimi i përbashkët kufizohet në kryerjen e krimeve në Jabllanicë, kjo nuk do të thotë se Prokuroria duhet të mbështetet vetëm në prova lidhur me ngjarjet në Jabllanicë, për të provuar se Haradinaj veproi së bashku me anëtarë të tjerë të NPK-së për realizmin e qëllimit të përbashkët.¹⁰⁴ Argumentohet se provat jo ngushtësisht të lidhura me ngjarjet në Jabllanicë, janë gjithsesi të rëndësishme për shkak se “tregojnë se krimet e pretenduara në Jabllanicë nuk ndodhën veçazi, por në kontekst të dhunës së ushtruar kundër personave që konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së.”¹⁰⁵ Konkretisht argumentohet se disa incidente kanë lidhje dhe vlerë provuese për prirjen kriminale të Haradinajt.¹⁰⁶ Parashtrohet se i takon Dhomës Gjyqësore të vendosë nëse provat e përmendura i përmbushin kriteret e pranimit.¹⁰⁷

2. Analizë

39. Meqenëse Dhoma Gjyqësore nuk mund të nxjerrë përfundime në lidhje me përgjegjësinë penale të Haradinajt jashtë akuzave në gjashtë pikat të cilat janë objekt i rigjyimit, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimin të gjykatësit Robinson, gjykon se përfshirja e pretendimeve të përgjithshme të lartpërmendura në “Paraqitja e fakteve” të Aktakuzës në Fuqi nuk e ballafaqon Haradinajn me akuza shtesë, as nuk e bën rigjykimin në vetvete të padrejtë.¹⁰⁸

¹⁰² Po aty, para 72.

¹⁰³ Po aty, para 76.

¹⁰⁴ Përgjigje, para 25.

¹⁰⁵ Po aty, para 26.

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty, para 25.

¹⁰⁸ Dhoma e Apelit thekson se në rigjykimin *Muvunyi*, Aktakuza i gjykit të parë mbeti aktakuza në fuqi për rigjykimin pa ndryshime, pavarësisht nga fakti që në gjyq *Muvunyi* ishte shpallur i pafajshëm për një akuzë dhe një akuzë tjetër u rrëzua. *Shih Prokurori k. Tharcisse Muvunyi-t*, Lënda Nr. ICTR 00-55/A-I, Aktakuzë, 23 dhjetor 2003; *Shih edhe Prokurori k. Tharcisse Muvunyi-t*, Lënda Nr. ICTR 00-55/A-T, Aktgjykim, 11 shkurt 2010, para 2, sh. 3.

40. I takon Dhomës Gjyqësore që nëpërmjet zbatimit të rregullave standarde mbi pranueshmërinë e provave të vlerësojë peshën dhe vlerën provuese të provave të përmendura prej Prokurorisë në lidhje me këto pretendime të përgjithshme, dhe të vendosë nëse marrja në konsideratë e provave të tilla do të përbënte paragjykim të tepruar ndaj Haradinajt në rigjykimin pas dhënies së pafajësisë.

41. Rrjedhimisht kjo pikë e apelit hidhet poshtë.

V. VENDIM

42. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatësit Robinson, e **RRËZON** Apelin në tërësi.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Patrick Robinson
Kryegjykatës

Këtij vendimi i bashkëngjitet mendimi pjesërisht mospajtues i gjykatësit Robinson.

Sot, më 31 maj 2011.

Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

MENDIM PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT ROBINSON

1. Në këtë Vendim Dhoma e Apelit përballlet me një numër problemesh ligjore të cilat nuk i ka hasur më parë për shkak se ky është rigjykimi i parë në Tribunal. Në lidhje me tri pikat e apelit, shumica e Dhomës së Apelit e mbështet arsyetimin thuajse tërësisht në Vendimin *Muvunyi* të Dhomës së Apelit të TPNR-së, deri më sot e vetmja çështje e dy tribunaleve ndërkombëtare *ad hoc* ku është trajtuar kuadri i provave që paraqiten në një rigjykim. Megjithatë pranoj se Vendimi *Muvunyi* shërben si pikënisje e vlefshme për diskutimin e problemit dhe sigurisht që ofron zgjidhje për disa aspekte të përmendura nga shumica, nuk pajtohem me mendimin e shumicës se Vendimi *Muvunyi*, i cili ka të bëjë me rigjykimin e një personi të shpallur fajtor, u jep zgjidhje të gjitha problemeve të ngritura në këtë Vendim i cili ka të bëjë me një person i shpallur i pafajshëm për të gjitha akuzat në gjykimin e parë. Konkretisht mendoj se në gjykimin e shkallës së parë Dhoma Gjyqësore mund dhe duhet t'u kushtonte më shumë rëndësi parimeve të tjera ligjore përkatëse dhe kuadrit të zbatimit të tyre në rrethanat e rigjyimit pas dhënies së pafajësisë, faktor që mund ta kishte ndihmuar në zgjidhjen e probleme të pranueshmërisë së provave që pashmangshmërisht do të dalin gjatë rigjyimit.

2. Pajtohem me konkluzionin e Vendimit në lidhje me Pikën 1 të Apelit, ndonëse kam rezerva në lidhje me faktin nëse arsyetimi i ofruar nga shumica trajton tërësisht të gjitha argumentet e paraqitura nga palët ose identifikon të gjithë parimet përkatëse ligjore në fjalë. Mendimi pjesërisht mospajtues ka të bëjë me Pikën 2 dhe 3 të Apelit.

A. Pika 2: A duhet të përfshijë Aktakuza në Fuqi të njëjtën akuzë për NPK-në si në gjykimin e parë

3. Nuk pajtohem me vendimin e shumicës në lidhje me pikën e dytë të apelit. Unë mendoj se bazuar në parimin *non bis in idem*, një person i cili është gjykuar në Tribunal, nuk duhet ballafaquar me rrezikun e shpalljes fajtor për një vepër penale në lidhje me të cilën është shpallur i pafajshëm ose me rrezikun e të trajtuarit si fajtor në çfarëdo kuptimi.¹ Në lidhje me këtë aspekt, parimi *non bis in idem* shërben si pengesë procedurale duke e parandaluar Prokurorinë prej ripretendimit të fajësisë të një të akuzuari kur më parë është

¹ Parimi *non bis in idem* është sanksionuar në Nenin 10 të Statutit të Tribunalit në lidhje me mbrojtjen që i ofrohet një personi të gjykuar në Tribunal, prej procedimit të mëtejshëm penal para një gjykate shtetërore për të

konkluduar kundër këtij pretendimi.² Kjo pengesë zbatohet *apriori* në Aktakuzë. Për më tepër doktrina *res judicata* kushtëzon se aspektet për të cilat është vendosur dhe rezultati është pasqyruar në Aktgjykim, duhen pranuar si të vërteta në kuptimin e aktgjykimit dhe nuk mund të debatohen ligjërisht nga të njëjtat palë në një proces vijues.³

4. Gjithashtu, theksoj se qëllimi në tërësi i një Aktakuze është përfshirja e akuzave kundër një të akuzuari dhe fakteve materiale në mbështetje të këtyre akuzave, të shtjelluara me saktësi të mjaftueshme në mënyrë që i akuzuari të vihet në dijeni.⁴ Rrjedhimisht Aktakuza duhet të jetë e saktë në lidhje me akuzat, pretendimet dhe kategoritë e përgjegjësisë.⁵

5. Qëllimi dhe kuadri i rigjykimit të pjesshëm është rigjykimi i Haradinajt në lidhje me ato pika të Aktakuzës në Fuqi për të cilat ai nuk është shpallur përfundimisht fajtor ose i pafajshëm, konkretisht në lidhje me gjashtë pikat e akuzave për krime të kryera në Jabllanicë. Pafajësia e tij në lidhje me të gjitha akuzat e tjera për krime në Aktakuzën në fuqi është përfundimtare dhe çfarëdo riakuzimi i Haradinajt për përgjegjësi në lidhje me këto pika është i ndaluar prej parimit *non bis in idem* dhe *res judicata*.

njëjtat “veprime që përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare” dhe anasjelltas veç rastit kur veprimi cilësohet krim ordiner ose kur procesi në një gjykatë shtetërore nuk ka qenë i paanshëm ose i pavarur, dhe ka synuar të mbrojë të akuzuarin nga përgjegjësia penale ndërkombëtare ose çështja nuk është proceduar me zellin e duhur. *Shih Prokurori k. Dushko Tadiqit me pseudonimin “Dule”*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Parimin *Non Bis In Idem*, 14 nëntor 1995, para 9; *Prokurori k. Naser Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-A, Vendim mbi Mocionin e Oriqit Lidhur me një Shkelje të *Non Bis In Idem*, 7 prill 2009, f. 5. Parimi themelor vlen gjithashtu edhe brenda juridiksionit të veçantë të Tribunalit. Kjo është pranuar nga TPNR. *Shih Prokurori k. Édouard Karemera-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-AR73.10, vendim mbi Mocionin e Joseph Nzirorera-s për Heqjen e Akuzës së Përbetimit me Juvenal Kajelijeli-n mbi Bazën e Ndalimit Kushtëzues, 16 korrik 2008, para 4.

² *Shih për shembull. R v Storey* [1978] HCA 39; (1978) 140 CLR, 364 në 373.

³ *Shih Prokurori k. Delaliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-96-21-T, Aktgjykim, 16 nëntor 1998, para 228; *Prokurori k. Bllagoje Simiqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-95-9-PT, Vendim mbi (1) Kërkesën e Stevan Todoroviqit për Rihapjen e Vendimit të 27 korrikut 1999, (2) Mocionit nga KNKK për Rihapjen e Urdhrit për Caktim Date të 18 nëntorit 1998, dhe (3) Kushtet për Njohjen me Materialin, 28 shkurt 2000, para 9-10; *Prokurori k. Radovan Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5/18-T, Vendim mbi Mocionin e të Akuzuarit për Mosmarrje në Konsideratë të Incidentit të Planifikuar të Granatuar mbi Bazën e Ndalimit Kushtëzues, 31 mars 2010, para 5. *Shih edhe Prokurori k. Casimir Bizimungu-t dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR 99-50-T, Vendim mbi Mocionin e Dytë të Prosper Mugiraneza-s për Eliminimin e privimit të tij nga E Drejta për Gjykim pa Vonesë të Tepruar, 29 maj 2007, para 6.

⁴ *François Karera k. Prokurorit.*, Lënda Nr. ICTR 01-74-A, Aktgjykim, 2 shkurt 2009, para 292.

⁵ Rrjedhimisht Dhoma ka konkluduar se Prokuroria duhet të argumentojë vetëm atë formë përgjegjësie të cilën synon t’a përdorë (*Prokurori k. Miroslav Kvočkës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, para 41). *Shih edhe Prokurori k. Bllagoje Simiqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-95-9-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2006, para 21, citohet ndër të tjera *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim 29 korrik 2004, para 215; *Prokurori k. Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000, para 171, sh 319; *Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit dhe Momir Taliqit*, Lënda Nr. IT-99-36-PT, Vendim mbi Kundërshtimet e Momir Taliqit për formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para 10; *Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-T, Vendim mbi Mocionin Paraprak në lidhje me Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11 shkurt 2000, para 60.

6. Në Aktgjykimin e vet, Dhoma Gjyqësore I nuk u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm mbi akuzën për ekzistencën e një NPK-je në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt, në të cilën merrnin pjesë tre të Akuzuarit, dhe si pasojë Dhoma konkludoi se të tre të Akuzuarit duheshin shpallur të pafajshëm për Pikat 6, 14, 20, 22, 30, 36 dhe 37, se Haradinaj dhe Balaj duheshin shpallur të pafajshëm për Pikat 28 dhe 32, dhe se Brahimaj nuk duhej ngarkuar me përgjegjësi për Pikat 28 dhe 32 si pjesëmarrës në NPK.⁶ Ky konkluzion që është pika kyçe e shkakut të rihapjes së çështjes nuk u apelua nga Prokuroria, veçse për atë sa Prokuroria kërkoi rigjykim në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, bazuar vetëm në pretendimin mbi pazotësinë e Dhomës Gjyqësore për t'iu kundërvënë kërcënimit të dëshmitarëve, dukuri që karakterizoi procesin gjyqësor dhe konkretisht për mosmundësimin e dëgjimit të dëshmisë së Kabashit dhe dëshmitarit tjetër. Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore I për pafajësinë e të Akuzuarve në lidhje me pjesëmarrje në një NPK-të gjerë nuk u cenua prej Aktgjykimit të Apelit, veçse brenda kuadrit të kufizuar të gjashtë pikave që janë objekt i rigjykimit. As pafajësia e shpallur në lidhje me akuzat për krime brenda qëllimit të përbashkët, nuk u apelua apo u cenua prej Aktgjykimit të Apelit.

7. Në bazë të këtyre fakteve dhe ligjit të lartpërmendur përkatës, nuk jam në gjendje të pranoj konkluzionin e shumicës. Pajtohem me Haradinajn se akuza e NPK-së e shtjelluar aktualisht në Aktakuzën në Fuqi kushtëzon që Prokuroria të provojë pretendime për të cilat Haradinaj është shpallur përfundimit i pafajshëm dhe të cilat dalin jashtë kuadrit të krimeve që do të gjykohen në procesin e rigjykimit.

B. Pika 3: A duhen fshirë nga Aktakuza në Fuqi akuzat që nuk kanë lidhje me gjashtë pikat të cilat janë objekt i rigjykimit

8. Gjithashtu nuk pajtohem me konkluzionin e shumicës në lidhje me pikën e tretë të apelit. Sipas mendimit tim, parimet *non bis in idem* dhe *res judicata*. e ndalojnë Prokurorinë të riparaqesë akuza për krime në lidhje me të cilat Haradinaj është shpallur përfundimisht i pafajshëm. Megjithatë disa paragrafë në Paraqitja e Fakteve thjesht përmbajnë pretendime të përgjithshme pa referenca konkrete për ndonjë nga krimet për të cilat Haradinaj është

⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para 478. Të tre të Akuzuarit u shpallën të pafajshëm për Pikat e mbetura në Aktakuzën e Ndryshuar për herë të Katërt për arsye të tjera.

shpallur përfundimisht i pafajshëm, disa paragrafë të tjerë për mendimin tim, kanë të bëjnë faktikisht me krime për të cilat ai është shpallur i pafajshëm. Paragrafët në fjalë të Aktakuzës në Fuqi janë 34-38 dhe 42-46. Përfshirja e tyre në Aktakuzën në Fuqi në formën aktuale, sipas mendimit tim shkel parimet *non bis in idem* dhe *res judicata* ose përbën shpërdorim të procesit.

9. Paragrafët e tjerë të Aktakuzës në Fuqi, konkretisht paragrafët 28(a)-(f), (j)-(m), 32-33, janë pretendime të gjera mbi fakte të cilat nuk ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi verdiktet përfundimtare të pafajësisë së Haradinajt. Nuk është e qartë se çfarë lloj provash synon të paraqesë Prokuroria në mbështetje të këtyre pretendimeve. Parimet ligjore përkatëse sugjerojnë se ndalohet që Prokuroria të paraqesë prova në qoftë se pranimi i tyre e përmbys pafajësinë.⁷

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/

Gjykatës Patrick Robinson

Sot, më 31 maj 2011.

Në Hagë

Holandë

⁷ *Shih edhe Sambavisum v. Public Prosecutor, Federation of Malaysia* [1950] në 458; *Director of Public Prosecution v. Humpreys* (1977) AC, në 43 (per Salmon L); *Garret v. The Queen* (1977) 139 CLR, 445 (per Barwick CJ).